



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	31-05-2021	viti god year	
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	2742/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.283/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani -anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën e datës 19.04.2021 me numër A.nr.283/2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rruga "Tahir Sinani", Hyrja C, Kati 2, Banesa Nr.B4 në Komunë të Lipjanit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.283/2021 e datës 19.04.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. **MBETET** në fuqi Vendimi me numër 1-112-10127 i datës 19.02.2021 i Kryetarit të Komunës së Lipjanit.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Lipjanit dhe Drejtori për Buxhet dhe Financa që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, t'i ndërmarr të gjitha veprimet procedurale ligjore për zbatimin e Vendimit me numër 1-112-10127 të datës 19.02.2021 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me pikën II të këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt emërimit të datës 02.04.2012 është i sistemuar në vendin e punës "Inspektor i Ndërtimitarisë" në Drejtorinë për Inspektorat të Komunës së Lipjanit, i cili sipas Vendimit me numër 1-116-6260 të datës 15.02.2017 të nxjerrë nga Kryetari i

Komunës së Lipjanit, është pezulluar nga puna me 50% të pagës nga data 15.02.2017 pasi që kanë marrë njoftimin nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës se ndaj tij është ngritur Aktakuzë PPS.Nr.75/2015 e datës 13.02.2017.

Kryetari i Komunës së Lipjanit me datë 19.02.2021 nxjerr vendimin me numër 1-112-10127 për kthimin e ankuesit në vend të punës nga data 01.03.2021 si "Inspektor i Ndërtimtarisë" në Drejtorinë për Inspektorat, me arsyetim se është liruar me Aktgjykimin nga Gjykata e Apelit të Kosovës Departamenti Special APS.nr.33/2020 i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 15.12.2020, po ashtu Kryetari i Komunës së Lipjanit në dispozitivin e dytë të këtij vendimi e obligon Drejtorinë për Buxhet dhe Financa që të bëjë kalkulimin financiar për kohën sa ka qenë ankuesi i pezulluar dhe ti kompensoj pagesën prej 50% të pagës nga data e pezullimit parandalues konkretisht nga data 15.02.2017.

Ankuesi me datë 02.03.2021 parashtron kërkesën me numër 6-120-12061 tek Drejtori për Buxhet dhe Financa si dhe te Shefi i Sektorit, për kompensimin e 50% të pagës nga data 15.02.2017 deri më 02.03.2021. Ankuesi pasi që nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e datës 02.03.2021 me datë 31.03.2021 parashtron ankesën me numër 1-400-17281 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Lipjanit. Udhëheqësja e Personelit e Komunës së Lipjanit më datë 02.04.2021 i përgjigjet kërkesës së ankuesit me numër 1-400-17281 me të cilën e njofton se: *"me hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrarët Publik nuk ka Komision të Ankesave brenda Administratës Komunale"*.

Ankuesi me datë 14.04.2021 parashtron ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nëpërmjet Postës së Kosovës, të cilën ankesë Këshilli e ka pranuar me datë 19.04.2021 me numër të protokollit 1845/2021 me pretendim ankimor për mos zbatim të vendimit me numër 1-112-10127 të datës 19.02.2021 të Kryetarit të Komunës së Lipjanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.04.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Lipjanit. Më datë 25.05.2021 ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë faqe 1/13.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 19.04.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 19.02.2021 i Kryetarit të Komunës së Lipjanit për kthim në vend të punës; Përgjigja e datës 04.03.2021 e Udhëheqëses së Personelit; Aktgjykimimi me numër të lëndës 2019:183058 i datës 25.09.2020 i Gjykatës Themelore të Prishtinës; Vendimi i datës 15.02.2017 për pezullim parandalues; Kërkesa e datës 02.03.2021 e ankuesit për Drejtorin për Buxhet dhe Financa; Kërkesa e datës 31.03.2021 e ankuesit e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Lipjanit; Përgjigja e datës 02.04.2021 e Udhëheqëses së Personelit; Kërkesa e datës 26.01.2021 e ankuesit për Zyrën e Personelit; Akt emërimi i ankuesit i datës 02.04.2021; Kartela e nëpunësit si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit

është e pa bazua, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi me Vendimin me numër 1-116-6260 të datës 15.02.2017 të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Lipjanit është pezulluar nga puna me 50% të pagës, për shkak se ndaj tij është ngritur aktakuza me PPS.Nr.75/2015 e datës 13.02.2017 sipas njoftimit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, të cilin pezullim e ka bërë në pajtim me 69 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 si dhe neni 2 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar se: *"1. Nëpunësit civilë pezullohen, me pagesë 50% të rrogës së tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse: 1.1. kundër tij/saj është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj; 1.2. nëpunësi civil mbahet në arrest në pritje të gjykimit; 1.3. kur prania e nëpunësit civil në zyrë mund të pengojë hetimet"*, ndërsa neni 2 ka përcaktuar se: *"Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi është liruar nga Aktakuza me Aktgjykim nga Gjykata e Apelit të Kosovës Departamenti Special APS.nr.33/2020, që është bërë i plotfuqishëm me datë 15.12.2020 dhe se Kryetari i Komunës së Lipjanit duke e bërë zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës ka nxjerr Vendimin me numër 1-112-10127 të datës 19.02.2021 me të cilin vendim, ankuesi kthehet në vendin e punës "Inspektor i Ndërtimitarisë" në Drejtorinë për Inspektorat të Komunës së Lipjanit dhe në pikën dy të dispozitivit e obligon Drejtorin për Buxhet dhe Financa që të kompensohet ankuesi për kohën sa ka qenë i pezulluar nga puna me 50% të pagës, rrjedhimisht Kolegji ka konstatuar se Vendimi me numër 1-112-10127 i datës 19.02.2021 i Kryetarit të Komunës së Lipjanit është nxjerr në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 69 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar se: *"Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi"*, andaj edhe pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e 50% të pagës më rastin e pezullimit parandalues është i bazuar pasi që ankuesi është liruar nga aktakuza.

Në rast të mos zbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndërmerr veprimet në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatim të Këshillit.



Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.283/2021.

Valentina Kaçandoll **BEKTESHI**


Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI **BAJRAKTARI**


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësve të Personelit në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.